



Komuna e Rahovecit me pikë maksimale (100 pikë) në Transparencë buxhetore për vitin 2022

Ky vlerësim është bërë duke u bazuar në numrin e dokumenteve buxhetore të publikuara, organizimin e dëgjimeve buxhetore me qytetarë, si dhe të përgjigjeve të komunave në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumente publike.



Komuna e Rahovecit, në kohë rekorde, realizon planin vjetor të të hyrave



Planifikimi i të hyrave për vitin 2023, ka qenë: 1,445,603.00 euro, totali i të hyrave deri më tani është: 1,449,782.46 euro. Me përmirësimin e procedurave të inkasimit, të pagesave *online* dhe me ndërgjegjësimin e qytetarëve, ne po ndërtojmë një sistem më efikas dhe të përshtatshëm për të gjithë.

U përrua objekti për të moshuar, për qëndrim ditor



Ky objekt bashkëkohor, u mundëson të moshuarve të komunës sonë qëndrim të rehatshëm dhe u jep hapësirë të zhvillojnë aktivitete të ndryshme gjatë ditës. Do t'u ofrohet edhe kujdesi shëndetësor, me praninë e mjekut dhe të infermierit.

Çmimi i këtij projekti është: 184,725.5.

Bëhet përrimi i fushës sportive në Malësi të Vogël



Në hapësirën e ShFMU "Skender Kastrati" në Malësi të Vogël, u përruan mjediset e reja sportive për futboll, basketboll dhe volejboll, që do t'u shërbejnë të rinjve, nxënësve dhe të gjithë qytetarëve të fshatit për sport e rekreacion.

Bëhet përurimi i përfundimit të depot e Matrex-it në Xërxë



Ky investim i bërë nga Komuna e Rahovecit, ka për qëllim krijimin e hapësirave të reja dhe të një mjedisi më të përshtatshëm për bizneset që operojnë në këto prona komunale

Për dy ditë me radhë (5,6 gusht), u mbajt AgroFesta në Krushë të Madhe

Kjo festë e perimekulturës u shënua me aktivitete të shumta gjatë dy ditëve, ku ndër të tjerash, qytetarët u njohën nga afër me fermerët dhe prodhimet e tyre. Produktet e fermerëve u ekspozuan në Panairin “Agro tregu”. AgroFesta u mbështet nga Komuna e Rahovecit.



Në kuadër të investimeve nga Komuna e Rahovecit, kanë përfunduar punimet në rregullimin e rrjetit të kanalizimit në fshatin Mrasor



Punimet në rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve fushore në fshatin Mrasor:



Po vazhdon shenjëzimi dhe vendosja e tabelave emërtuese të rrugëve në komunën e Rahovecit

